



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 74-të, të mbajtur më 06.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4176/1, datë 25.10.2021, me pretendime për parregullsi në dhënien e tenderëve për transport personit juridik privat në vitin -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprimin kompetent, sepse nuk ka pohime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar gjatë ushtrimit të autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare.

Lënda me numër 12 -4176/1 të datës 25.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 25.10.2021, u dorëzua denoncim anonim me numër 12-4176/1, datë 25.10.2021, me pretendime për dhënien e tenderëve për transport për transportuesin ----- i ----- dhe kërkohet fillimi i procedurës ndaj personit juridik të caktuar. Në denoncimin e dorëzuar me pretendime të përgjithshme, pa specifikuar persona dhe aktivitete të veçanta, dhe nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin për faktin se në denoncimin e dorëzuar nuk ka pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencat publike dhe detyrat zyrtare, dhe KSHPK-ja nuk ka mundësi të japë informacion shtesë për pretendimet në denoncim(aplikacion anonim), dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

Përgatiti: J.C.

Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

